

VENDIM
Nr. 135, datë 22.2.2017

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK DHE PAKËSIMIN NË
VOLUM TË SIPËRFAQES PREJ 38.6 HA NË OBJEKTIN “LESHNICA”, BASHKIA
KUKËS,QË DO TË PËRDORET NGA SHOQËRIA “LLAGNAT”, SH.P.K. PËR
SHFRYTËZIMIN E MINERALIT
TË HEKUR-NIKELIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr.9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe të ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore dhe kullimore publike prej 38.6 ha, që do të përdoret nga shoqëria “Llagnat”, sh.p.k. për shfrytëzimin e mineralit të hekur-nikelit në objektin “Leshnicë”, Bashkia Kukës, të hiqet nga fondi pyjor dhe kullor publik, të pakësohet në volum dhe çregjistrohet nga Regjistri i Kadastrës së Pyjeve dhe Kullotave. Lidhja 1, me të dhënat për sipërfaqet pyjore që pakësohen në volum, dhe harta topografike, me koordinatat e sipërfaqes objekt minerar, i bashkëngjiten këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Vlerat përkatëse të pakësimit në volum të lëndës drusore, produkteve të tjera pyjore e kullimore dhe të investimeve të kryera në vite, objekt i këtij vendimi, paguhet nga shoqëria “Llagnat,” sh.p.k., në bazë të lidhjes 4, të vendimit nr.391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar, dhe derdhen në llogarinë bankare të Bashkisë Kukës.

3. Shoqëria “Llagnat”, sh.p.k., brenda 3 viteve, nga data e nënshkrimit të marrëveshjes me Bashkinë Kukës, të pyllëzojë me fondet e veta, me drurë pyjorë, një sipërfaqe prej 20 ha.

4. Bashkia Kukës dhe shoqëria “Llagnat”, sh.p.k. nënshkruajnë marrëveshjen e bashkëpunimit jo më vonë se 60 ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Një kopje e marrëveshjes, së bashku me projektet e miratuara, dërgohet në Ministrinë e Mjedisit, jo më vonë se 10 ditë nga data e nënshkrimit të saj.

5. Sipërfaqet pyjore, sipas lidhjes 1, të këtij vendimi, mbeten pronë publike e shtetit dhe regjistrohen në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

6. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme bën çregjistrimin e sipërfaqes pyjore të identifikuar sipas lidhjes 1, të këtij vendimi, nga kategoria “Tokë e zënë pyjore” dhe e regjistron në kategorinë “Tokë e zënë, objekt i aktivitetit minerar”.

7. Me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në planin e rehabilitimit, sipas lejes mjedisore, nga shoqëria “Llagnat”, sh.p.k., sipërfaqja e rehabilituar të regjistrohet në fondin pyjor dhe kullor publik të Bashkisë Kukës.

8. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Bashkia Kukës dhe shoqëria “Llagnat”, sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

BASHKIA KUKËS**LISTA E NGASTRAVE DHE N/NGASTRAVE TË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR
PUBLIK QË HIQEN PËR SHFRYTËZIMIN E MINERALIT TË HEKUR-NIKELIT
NGA SUBJEKTI “LLAGNAT” SHPK**

Nr.	ID pones	Ekonomia pyjore/Kullosore	Ng/ n/ngast.	Siperfaqja qe hiqet nga fondi pyjor/ kullosor ha
<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>
1	KU32 00 072a	Mamez Kalimash	72a	1
2	KU32 00 072b	Mamez Kalimash	72b	7.123
3	KU32 00 074b	Mamez Kalimash	74b	11.112
4	KU32 00 074c	Mamez Kalimash	74c	4.922
5	KU32 00 075a	Mamez Kalimash	75a	0.102
6	KU32 00 075b	Mamez Kalimash	75b	5.69
7	KU32 00 075c	Mamez Kalimash	75c	8.11
8	KU32 00 076b	Mamez Kalimash	76b	0.031
9	KU32 00 076c	Mamez Kalimash	76c	0.51
GJITHSEJ				38.6

HARTA TOPOGRAFIKE ME KUFIJTE E LEJES Nr.1796 DHE SIPERFAQET PER HEQJE NGA FONDI PYJOR

Shkalla 1: 25 000

Objekti "Leshnica", Kukes Shoqeria "LLAGNAT" sh.p.k.



